

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) dhe në lidhje me nenin 19, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM për bonot e thesarit

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) i përcakton kushtet dhe mënyrën e emitimit, tregtimin dhe mënyrën e pagesës së bonove të thesarit të Bankës Popullore, në denarë (në tekstin e mëtejshëm: bonot e thesarit).

2. Bonot e thesarit janë letra me vlerë afatshkurtër, të cilat emetohen në formë jomateriale.

Emitimi i bonove të thesarit përfshin shitjen fillestare të bonove të thesarit nga ana e Bankës Popullore nëpërmjet realizimit të ankandeve për bono të thesarit.

3. Të drejtë pjesëmarrjeje në ankandet e bonove të thesarit kanë bankat, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret, të cilat kanë detyrim për plotësimin e rezervës së detyruar në Bankën Popullore (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarësit).

II. ANKANDET

4. Në prospekt përcaktohet tipi i tenderit për mbajtjen e ankandit për bonot e thesarit: tender me shuma ose tender me norma të interesit.

5. Gjatë tenderit me shuma, në prospekt definohet norma e interesit dhe mund të kufizohet shuma e ankandit ose të përcaktohet shumë e pakufizuar e bonove të thesarit.

Në rast të ankandit me shuma, pjesëmarrësit marrin pjesë vetëm me shuma (shuma nominale e bonove të thesarit).

Në rast të ankandit me shuma dhe me shumë të kufizuar të bonove të thesarit, mund të përcaktohet shuma maksimale e ofertës për çdo pjesëmarrës, sipas përqindjes së detyrimeve të pjesëmarrësit në valutë vendase pa klauzulë devizore nga baza për përcaktimin e rezervës së detyruar, në totalin e detyrimeve në valutë vendase pa klauzolë devizore nga baza për përcaktimin e rezervës së detyruar, për periudhën e përmbushjes në të cilën mbahet ankandit. Shuma maksimale e ofertës së pjesëmarrësit është e barabartë me shumën e fituar duke aplikuar përqindjen e duhur të pjesëmarrjes në shumën e bonove të thesarit të përcaktuar në prospekt. Banka Popullore para mbajtjes së ankandit i informon pjesëmarrësit për shumën maksimale për pjesëmarrje në ankand nëpërmjet postës elektronike.

Në qoftë se pjesëmarrësi dërgon ofertë më të madhe se oferta maksimale e përcaktuar në paragrafin e 3-të të kësaj pike, Banka Popullore e pranon ofertën deri në shumën e caktuar maksimale.

6. Gjatë ankandit me norma të interesit, në prospekt tregohet shuma e bonove të thesarit dhe mund të përcaktohet norma maksimale e interesit (çmimi minimal).

Pjesëmarrësit marrin pjesë në ankand me shuma (shuma nominale e bonove të thesarit) dhe me çmime (normë të interesit), e përcaktuar saktësisht deri në katër dhjetore.

Çmimi për 100 njësi vlerë nominale të bonove të thesarit llogaritet sipas formulës:

$$C = \frac{100}{1 + \frac{KS * D}{36000}}$$

Nga ku,

C = çmimi në 100 njësi vlerë nominale e bonove të thesarit;

KS = norma vjetore e interesit (në %);

D = numri i ditëve deri në maturim.

Banka Popullore në prospekt mund ta kufizojë numrin e ofertave për pjesëmarrje në ankand.

7. Ankandet mbahen regullisht, për të cilat Banka Popullore publikon Kalendarin Indikativ para fillimit të vitit aktual në faqen e internetit të Bankës Popullore.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, Banka Popullore mund të mbajë ankand të jashtëzakonshëm. Banka Popullore i njofton pjesëmarrësit për kohën e mbajtjes së ankandit të jashtëzakonshëm nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet postës elektronike.

III. PROSPEKT

8. Banka Popullore, nëpërmjet Sistemit elektronik të Bankës Popullore për operacione të tregut (në tekstin e mëtejshëm Sistemi elektronik), dërgon prospektin të gjithë pjesëmarrësit, në të cilin janë të përcaktuara kushtet për pjesëmarrje në ankand.

9. Në prospekt janë të përcaktuara:

- data e mbajtjes së ankandit;
- koha e mbajtjes së ankandit dhe koha e pranimit të ofertave për pjesëmarrje në ankand;
- tipi i tenderit për mbajtjen e ankandit;
- shenjë e ankandit në formatin e mëposhtëm: CBYYYY/NNN-DDD;

Nga ku,

BQ tregon se bëhet fjalë për bono të thesarit të bankës qendrore;

YYYY tregon vitin e emitimit të bonove të thesarit;

NNN është numri rendor i ankandit, dhe

DDD tregon numrin e ditëve të maturimit të bonove të thesarit

- data e maturimit të bonove të thesarit;
- shuma e bonove të thesarit dhe
- çmimi i përcaktuar në saktësi deri në katër dhjetore në ankandin me shumë ose në ankandin me normë të interesit me çmim të caktuar minimal, që korrespondon me normat e përcaktuara të interesit..

Në Prospekt mund të definohet:

- Shuma maksimale e ofertave individuale, e shprehur si përqindje e shumës së ofruar në ankand;
- diferenca minimale ndërmjet çmimeve individuale të ofertave të secilës bankë; dhe
- numri maksimal i ofertave me të cilat pjesëmarrësit mund të marrin pjesë në ankand.

Shuma minimale për pjesëmarrje në ankand është 5.000.000 denarë. Çdo rritje e ardhshme mbi shumën minimale bëhet duke shtuar shuma të rrumbullaksuara nga 1.000.000 denarë.

IV. OFERTA PËR PJESËMARRJE NË ANKAND

10. Pjesëmarrësit dërgojnë oferta për pjesëmarrje në ankand nëpërmjet Sistemit elektronik, duke përdorur emrin përdorues personal dhe fjalëkalimin. Banka Popullore nuk ka njohuri për të dhënat që pjesëmarrësit i paraqesin në oferta.

Ofertat e dërguara janë të pakthyeshme pas kalimit të kohës së përcaktuar për pranimin e ofertave.

Në rast të problemeve teknike nga ana e pjesëmarrësve gjatë përdorimit të Sistemit elektronik, pjesëmarrësi mund të mer pjesë në ankand duke dërguar oferta deri te Banka Popullore nëpërmjet postës elektronike apo faksit, më së voni 15 minuta pas përfundimit të kohës për pranimin e ofertave.

11. Ofertat të cilat nuk i plotësojnë kushtet të parapara në këtë vendim nuk do të pranohen.

V. PARIMET E SHPËRNDARJES SË OFERTAVE

12. Në varshmëri nga lloji i ankandit, ofertat shpërndahen sipas principeve të caktuara.

Në rast të ankandit me shuma, kur kërkesa totale e tejkalon ofertën, ofertat shpërndahen në raport me shumën e ankanduar (parimi i shpërndarjes proporcionale). Në rast se shuma e bonove të thesarit është e pakufizuar, ofertat e pjesëmarrësve pranohen plotësisht.

Në rast të ankandit me norma të interesit, ofertat shpërndahen sipas çmimit të ofruar (normës së interesit) duke filluar nga çmimi më i madh (norma e interesit më e ulët) – principi i prioritetit të çmimit të ofruar (normës së interesit). Nëse ndodh që disa pjesëmarrës të ofrojnë të njëjtin çmim më të ulët të pranuar (normë të interesit), ndërsa kërkesa totale e tejkalon ofertën, ofertat shpërndahen në raport me shumën e ankanduar (parimi i shpërndarjes proporcionale).

Ofertat shpërndahen sipas parimit të shpërndarjes proporcionale sipas formulës:

$$P = A * (V_2 / V_1)$$

Nga ku,

P = pjesa e pranuar e ofertës së pjesëmarrësit (nga oferta me çmim më të ulët të pranuar);

A = oferta e pjesëmarrësit (oferta e pjesëmarrësit me çmim më të ulët të pranuar);

V_1 = shuma totale e kërkuar nga të gjithë pjesëmarrësit (shuma totale e pjesëmarrësve me çmim të njëjtë më të ulët të pranuar);

V_2 = shuma totale që do ta pranoj Banka Popullore (shuma totale nga ofertat me çmim më të ulët të pranuar).

Nëse gjatë shpërndarjes proporcionale, si rezultat i rrumbullakimit matematikor të shumave të shpërndara, paraqitet nevoja për të rritur shumën e realizuar, shuma e realizuar mund të rritet në raport me shumën e ofruar.

VI. REZULTATET E ANKANDIT

13. Pjesëmarrësit njoftohen për rezultatet e ankandit nëpërmjet Sistemit elektronik, dhe të njëjtat publikohen edhe në faqen e internetit të Bankës Popullore.

Në rast të ankandit me norma të interesit, rezultatet e ankandit përmbajnë të dhëna për shumën totale të realizuar, për çmimin e ponderuar (mesatar) (normën e interesit) të ankandit, si dhe për çmimin minimal dhe maksimal (normën e interesit) të ofertave të pranuar.

Çmimi i ponderuar (mesatar) llogaritet sipas formulës:

$$\text{Çmim i ponderuar} = \frac{\sum_{i=1}^n C_i * P_i}{\sum_{i=1}^n P_i}$$

Nga ku,

C = çmimi i ofertës së pranuar;

P = shuma e ofertës së pranuar;

n = numri i ofertave të pranuar.

Në rast të ankandit me shuma, rezultatet përmbajnë të dhëna për shumën totale të realizuar.

14. Çdo pjesëmarrës ka qasje te rezultatet personale nga ankandi, nepërmjet Sistemit elektronik.

Rezultatet e ankandit përmbajnë oferta të pranuar/ose oferta të refuzuara.

Ofertat e pranuar realizohen sipas kushteve të ofruara dhe në pajtim me rezultatet e ankandit.

VII. PAGESA DHE REGJISTRIMI I BONOVE TË THESARIT

15. Pjesëmarrësit janë të detyruar të bëjnë pagesën e shumës së diskontuar të bonove të thesarit nga ofertat e pranuar në llogari të Bankës Popullore, në ditën e ankandit.

Shuma e diskontuar pasqyron çmimin dhe normën përkatëse të interesit sipas së cilës pjesëmarrësit kanë blerë bonot e thesarit në trgun primar.

Shuma e diskontuar llogaritet sipas formulës:

$$DI = \frac{NI * C}{100}$$

Nga ku,

DI – shuma e diskontuar;

NI – shuma nominale;

C - çmimi.

16. Pas përfundimit të pagesave nga ana e pjesëmarrësve, Banka Popullore i evidenton bonot e thesarit në depozitarin e bonove të thesarit në Bankën Popullore.

Me kërkesë të pjesëmarrësve, Banka Popullore lëshon certifikatën e pronësisë së bonove të thesarit.

17. Në rast se pjesëmarrësi nuk bën pagesën përkatëse të mjeteve në lartësi të ofertës së pranuar, Banka Popullore nuk do t'i evidentojë bonot e thesarit në depozitarin për shumën e mjeteve që nuk janë paguar dhe do të llogaritet normën ligjore të interesit në shumën totale që pjesëmarrësi ka qenë i detyruar ta paguaj.

Pjesëmarrësi është i obliguar të paguajë normën e interesit ligjor në pajtim me paragrafin 1 të kësaj pike në afat prej tetë ditësh nga dita e marjes së detyrimit.

Banka Popullore e kufizon të drejtën e pjesëmarrjes në ankande të bonove të thesarit pjesëmarrësit i cili në dy ankandet e mëparshme të njëpasnjëshme nuk ka paguar shumën e duhur të mjeteve, në pajtim me paragrafin 1 të kësaj pike.

VIII. NDËRPRERJA E PROCESIT TË ANKANDIT

18. Procesi i ankandit të bonove të thesarit mund të ndërpritet në rast të:

- ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike;
- mosfunksionimit të mjeteve të komunikimit dhe serverëve;
- Akt i forcës madhore (vis major).

Në rast të shfaqjes së ndonjërit prej reziqeve të përmendura, ankandi i bonove të thesarit anulohet. Banka Popullore i informon pjesëmarrësit për datën dhe kohën e mbajtjes së ankandit të ardhshëm të bonove të thesarit.

19. Në rast të problemeve teknike të Bankës Popullore gjatë përdorimit të Sistemit elektronik, pjesëmarrësit informohen për prospektin dhe rezultatet e ankandit nëpërmjet telefonit, faksit ose ndonjë mënyre tjetër informimi. Pjesëmarrësit i dërgojnë ofertat për pjesëmarrje në ankandin e bonove të thesarit nëpërmjet postës elektronike, faksit apo ndonjë mënyre tjetër të shkruar informimi.

IX. TREGTIM DHE PAGESA

20. Me bonot e thesarit mund të tregtohet në tregun sekondar ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

Tregtimi me bonot e thesarit në tregun sekondar kryhet deri në ditën e punës që i paraprin ditës së maturimit të bonove të thesarit.

Guvernatori miraton Udhëzim për shlyerjen e transaksioneve me bonot e emituara të thesarit.

21. Në ditën e maturimit të bonove të thesarit, Banka Popullore bën ripagesën e vlerës nominale të bonove të thesarit.

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

22. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi për bonot e thesarit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 166/13, 30/15, 35/15 и 148/15).

23. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/XXI-4/2022
30 nëntor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
dr. Anita Angellovska-Bezhoska